VENDIM
Nr.1001, datë 2.7.2008

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.901, DATË 19.12.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, NËPUNËSVE TË KABINETEVE DHE PUNONJËSVE MBËSHTETËS NË ADMINISTRATËN E DISA INSTITUCIONEVE TË PAVARURA", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.901, datë 19.12.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pas shkronjës "f" të pikës 1, shtohet shkronja "g", me këtë përmbajtje:

"g) Administrata e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.".

2. Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Në pikën 3, vlera "10 050 lekë" zëvendësohet me "11 000 lekë".

4. Shkronja "c" e pikës 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"c) Paga për pozicionet "Sekretar i titullarit" e "Sekretar i organit kolegjial drejtues" është 50 000 lekë në muaj. Shtesa për vjetërsi në punë, për pozicionet "Sekretar i titullarit" e "Sekretar i organit kolegjial drejtues", jepet në masën 2 për qind pas çdo viti pune, deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi vlerën 11 000 lekë.".

5. Vendimi nr.456, datë 3.7.2003 i Këshillit të Ministrave "Për strukturën dhe nivelet e pagave të punonjësve të administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë", i ndryshuar, shfuqizohet.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara për politikën e pagave, për vitin 2008.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA NR.1

PAGA MUJORE						
KLASA	**POZICIONI**	**KATEGORITË**	**PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)**			**SHTESA PËR POZICION**
		1	**2**	**3**	**4**	**5**
			Paga e grupit	**Shtesa vjetore**	**Shtesa për kualifikim**	**Shtesa për pozicion**

			(PG) lekë	**për vjetërsi (SHV), në përqindje**	**(SHK), lekë**	**(SHP), lekë**
I	Sekretar i Përgjithshëm	I-b	11 000	2%		114 000
II	Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme	II-a	11 000	2%		103 500
	Drejtor drejtorie	II-b	11 000	2%		86 500
III	Përgjegjës sektori, Inspektor i auditimit të brendshëm	III-a	11 000	2%		68 500
	Përgjegjës sektori	III-a/1	11 000	2%		58 300
	Specialist i nivelit të lartë, Inspektor i auditimit të brendshëm	III-b	11 000	2%		51 500
IV	Specialist i nivelit të mesëm	IV-a	11 000	2%		39 000
	Specialist	IV-b	11 000	2%		29 000